

Tirane, me 18.4.1987

Sh.rikel Gjika me tel. Nr.449 date 4.4.1987 njofton te
dhenat e bari-it "6110".

Sipas Aleksander Kondos, me daten 20 mars, nje person i pa njohur i ke shkatuar nje aksident te rende dhe shpetoi per mbre kulli nga vëekja. Thuu disa brinje dhe demtoi rende qafen, por ne spitalte qendroi vetem 3 dite. Shprehu dyshim se dikush tentoi te vriste ne autostrate duke e ndaluar përe tij mekinen papritmas me shpejtesi. Me qen se re pa ndjenja, nuk mesoi gje per atentatorin dhe deri me sot nuk di asgje. Tha se per te kujdeset nje vendese qe ai dashuron, nuk ke perse te punoje dhe gjithë ditën sorollatet qytetit. Flet kunder regjimit tone bile edhe kunder te jatit, qe e ka spiunuar ne organet, por nuk ka ekspozuar ndonje veprim te demshem kunder nesh.

2.- Sipas [redacted], jugosllavet dy javet e fundit kane derguar ketu shume njerez te tyre per te propaganduar e sqersuar opinionin kosovar dhe emigracionin politik shqiptar per gjendjen e qete ne Kosove dhe pamundesine e ngjarjeve te reja ne vend. I tille eshte [redacted], profesor ne Prishtine, ardhur ketu me nje ekip kulturor dhe qe ka shetitur dy javet e fundit ne çdo qytet ku ka emigraente shqiptare. Saati ke folur mire per gjendjen ne Jugosllavi dhe ka akuzuar Shqiperine per nxitjen e trazirave ne Kosove. Propaganda se kosovaret tashme e kane kapTUR politiken e Tiranes dhe nuk duan te gjakosen. Ka thene se qeveris federative po punon me dy superfuqite per te nxjerre vendin nga kriza e borxheve.

3.- Sipas [redacted] ne ka-pin e Beogradit gjenden sot 20 te arratisur shqiptare, e numeri tyre po rritet dite dite. Nder ta ndodhen dy çifte dhe se te gjithë priten te vijen e stabilizohen ketu. Do te pyeten hollësisht dhe merren intervista per ti perdorur per propagande kunder shqijeve te te drejteve te njeriut ne Shqiperi. Tha se disa i derson siguri-i shqiptar, por vendesit do te bejne kujdes. Duke kundërshtuar [redacted] theksoi se keta te arratisur qe jane rrugaçe e vëgbonde dhe qe ketu flasin mire per gjendjen ne Jugosllavi nuk i dergon siguri-i shqiptar, por UDB-a per te kontrolluar emigracionin shqiptar qe lufton kunder tyre.